



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 3/9 DATË 15 / 07 / 2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 3/5 DATË 29.03.2021 TË KIS "PËR
MIRATIMIN E STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË
E ASISTUAR" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT "DREAMADES LUXURY SUITES",
ME SUBJEKT "AG.TCC" SH.P.K ME NUIS L52227046H"**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike, me Vendimin nr. 3/5 datë 29.03.2021 ka vendosur miratimin e Statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" për projektin e investimit "Dreamades Luxury Suites". Projekti "Dreamades Luxury Suites" do të realizohet nga shoqëria investuese "AG.TCC"

SH.P.K me NUIS L52227046H. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.

- Në përputhje Vendimin e KIS Vendimin nr. 3/5 datë 29.03.2021, shoqëria investuese ka përfituar masën mbështetëse të lejimit të përdorimit të bregut para hotelit për një periudhë 30 vjeçare.
- Shoqëria investuese synon që zonën e bregdetit ta përdorë ekskluzivisht për zhvillimin e veprimtarisë turistike në shërbim të Hotelit që po zhvillohet dhe, për këtë qëllim, në këtë zonë planifikohet të instalohen disa stacione plazhi, ku synohet të ofrohet shërbim i cilësisë së lartë, në përputhje edhe me standardet më të mira ndërkombëtare.
- Për këtë arsye, por edhe me qëllim që subjekti investues të mund të përfitojë nga incentiva e reduktimit të TVSH-së, pika 2, neni 11/1 i VKM nr. 953 datë 29.12.2014, subjekti investues do të krijojë një shoqëri të dedikuar (SVP).
- Aktualisht shoqëria investuese "AG.TCC" sh.p.k. ka lidhur një marrëveshje me shoqërinë "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k., për operimin e strukturave turistike në projektin Dreamades Luxury Suits, ku përfshihet edhe operimi i stacioneve të plazhit në bregun përballë hotelit.
- Subjekti ka paraqitur kërkesë edhe për ndryshimin e Vendimit Nr. 3/5 datë 29.03.2021 të KIS, duke kërkuar reflektimin e kësaj marrëveshje, për t'i mundësuar kështu përfitimin e benefitit të përdorimit të bregut (sipas pikës 8 të vendimit) shoqërisë "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k., në përputhje edhe me marrëveshjen midis palëve.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe duke qenë se lloji i projektit të synuar nuk ka ndryshuar dhe vlera e investimit me numrin e punësimit plotësojnë kriteret e parashikuar nga legjislacioni,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. *Titulli i Vendimit të KIS Nr. 3/5 datë 29.03.2021 "Për miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit "Dreamades Luxury Suites", me subjekt "AG.TCC" sh.p.k me NUIS L52227046H", si më poshtë vijon:*

"Për miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit "Dreamades Luxury Suites", me subjekt "AG.TCC" sh.p.k me NUIS L52227046H dhe "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k., me NIUS M11825022K".

2. *Vendimi i KIS Nr. 3/5 datë 29.03.2021 ndryshon si më poshtë vijon:*

"Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Subjekti aplikues propozon zhvillimin e një investimi kompleks, të përbërë nga një Hotel me 5*, i nivelit të lartë, i konceptuar në disa kate me tarraca dhe do të ketë një kapacitet prej 106 suitea.
- Projekti zë një sipërfaqe zhvillimi prej 10,592 m², në Zonën Kadastrale 1739 dhe 1481, në Gjilekë, Bashkia Himarë.
- Vlera e investimit të projektit "Dreamades Luxury Suites" plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë

5,556,192 (pesë milion e pesëqind e pesëdhjetepesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) Euro.

- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike, duke parashikuar të punësojë 120 persona.
- Subjekti ka lidhur kontratë me brand ndërkombëtar.
- Subjekti është i pajisur me Vendim KKT, Nr. 21 “Për miratimin e e lejes së ndërtimit për objektin “Kompleks Turistik Dreamades Luxury Suites, me objektet 1-2-3 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, Dhërmi Bashkia Himarë””, i cili është zbardhur me Dokumentin e Lejes së Ndërtimit 1104/09 Prot, datë 31.12.2020, sipas vendimit të KKT të sipërcituar.
- Bashkia Himarë ka Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkisë Himarë”, të KKT.
- PPV e bashkisë Himarë është rishikuar me Vendimin nr. 5, datë 10.6.2020 të KKT “Dokument i rishikimit të Plani të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë”.
- KKT ka miratuar dhe “Rregulloret dhe parametrat cilësorë për investimet strategjike në vendet me rëndësisë kombëtare për zhvillimin e turizmi”.
- Nënkatëgoria e përdorimit të tokës për një nga zonat ku përfshihet projekti është shpallur Zonë me Përparësi Zhvillimi e Turizmit (ZPZT).

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Dreamades Luxury Suites”.

2. Projekti "Dreamades Luxury Suites" do të realizohet nga subjektet "AG.TCC" SH.P.K me NUIS L52227046H dhe "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k. me NUIS M11825022K".
3. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti parashikohet të zhvillohet në një sipërfaqe zhvillimi prej 10,592 m², në Zonën Kadastrale 1739 dhe 1481, në Gjilekë, Bashkia Himarë.
5. Projekti parashikon realizimin e zhvillimit të një investimi kompleks, të përbërë nga një Hotel me 5*, i nivelit të lartë, i konceptuar në disa kate me tarraca dhe do të ketë një kapacitet prej 106 suita.
6. Statusi "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" i jepet projektit të investimit "Dreamades Luxury Suites", për një periudhë 4 (katër) vjeçare, përveç afatit të lejitimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, neni 23 dhe neni 29 i Ligj Nr.55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit do të përfitohen nga subjekti "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k. me NUIS M11825022K" dhe janë si më poshtë:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e

projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;

c) Miratohet në parim masa mbështetëse për konsolidimin e tokës dhe pronës ku do të zhvillohet projekti.

d) Miratohet masa akses në infrastrukturë mbështetëse në bazë të legjislacioneve sektoriale.

8. Në zbatim të nenit 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar, subjektit "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k. me NIUS M11825022K" i miratohet në parim masa mbështetëse e lejitimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit nr. rep. 695, nr. kol. 420 datë 30.06.2021, të nënshkruar me shoqërinë "AG.TCC" sh.p.k., por në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet.

Miratimi përfundimtar, koordinatat e sakta si dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, sipas parashtrimeve të hartës në Aneksin 1 të dokumentacionit që ka dorëzuar subjekti për aplikim.

9. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "Dreamades Luxury Suites" konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për

dhënien e statusit strategjik.

11. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
12. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave VKM "Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik "Dreamades Luxury Suites".
13. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" ngarkohet Bashkia Himarë për përcaktimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte
14. Referuar Ligj Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", ngarkohet Bashkia Himarë të përfshijë projektin e investimit në Vlerësimin Strategjik Mjedisor.
15. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për fillimin e regjistrimit fillestar të zonës dhe për paraqitjen dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në regjistrin kadastral lidhur me zonën në zhvillim.
16. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorim të realizimit të projektit të investimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “DREAMADES LUXURY SUITES”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit

"Dreamades Luxury Suites"

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit *"Dreamades Luxury Suites"*, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit *"Dreamades Luxury Suites"* është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitorët:

Investitori "AG.TCC" SH.P.K me NUIS L52227046H dhe "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k. me NIUS M11825022K", kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik, të cilat do t'i miratohen shoqërisë "AGTCC HOTEL MANAGEMENT" sh.p.k. me NIUS M11825022K.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në fazë. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Dhënia në përdorim përmes një kontrate afat-gjatë e plazhit publik, sipas parashtrimeve të Hartës në Aneksin 1 të projektit.	PO	MFE MTM BASHKIA HIMARË	Kjo masë miratohet nëpërmjet një VKM që propozohet nga MFE. dhe MTM. MTM ka vlerësuar se sipërfaqja e plazhit që kërkon të marrë në përdorim subjekti përkon me 2 parcela plazhi (sipas ndarjes së vitit 2020), të cilat ishin përcaktuar për investitorë strategjikë. Kjo sipërfaqe plazhi (në gjatësi) nuk është përtej koordinatave që i takojnë vijës bregdetare që i përkon projektit të investimit.	Identifikim të gjendjes kadastrale e juridike të sipërfaqes në fjalë.		
Konsolidimi i tokës dhe pronës ku do të	Po	ASHK BASHKIA	Regjistrimi fillestar është përgjegjësi e			

<p>zhvillohet projekti , duke përfshirë fillimin e procesit të regjistrimit fillestar.</p>		<p>HIMARË</p>	<p>ASHK.</p> <p>Prona ku do të zhvillohet projekti është pjesë e fondit bujqësor, pronë private.</p> <p>Projekti është në përputhje me PPV-në për këtë bashki dhe me politikat dhe rregulloren për mënyrën e zhvillimit të kësaj zone si dhe gjen zbatim ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe neni 25, pika 4/1 te ligji nr. 42/2019. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, sipas rastit, ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit.</p>			
--	--	---------------	--	--	--	--

<p>Të përfitojë asistencë dhe procedurë të përshpejtuar për çdo akt administrative dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse të furnizimit me ujë, për në objekt. (Lidhja me pikat ekzistuese për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm)</p>	<p>PO</p>	<p>Bashkia Himarë</p>	<p>Aktualisht zona ka një prurje dhe një rrjet ekzistues. Pavarësisht kësaj, aktualisht po bëhet një rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të kësaj zone (Perivolo) të ujërave të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza e cila do të krijojë mundësinë e shumë pika lidhjeje dhe përmirësimin e prurjes duke krijuar garanci furnizimi me ujë për këtë subjekt.</p>			
<p>Të përfitojë asistencë dhe procedurë të përshpejtuar për çdo akt administrative dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse të furnizimit me energji elektrike për në objekt (Lidhja me pikën ekzistuese të energjisë elektrike në afërsi të</p>	<p>PO</p>	<p>MIE Bashkia Himarë OSHEE</p>	<p>Ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” Neni 27 Lidhja me rrjetin. Kompetencë e Bashkisë Himarë sipas Ligjit, Nr. 139 /2015_PËR VETËQEVERISJEN VENDORE.</p>	<p>Dokumentacioni që kërkohet për aplikim lidhje të re sipas vendimit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016 për miratimin e “rregullore për lidhjet e reja në sistemin e</p>		

zonës).		<p>Shoqëria pavarësisht statutit të projektit që mund të gëzojë në përputhje me ligjin Nr. 55/2015 Për investimet strategjike ne RSH, duhet të ketë në konsideratë parashikimet e ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe konkretisht neneve 27, 28 dhe 29 të saj ku përcaktohet se:</p> <p>Neni 27</p> <p>Lidhja me rrjetin</p> <p>1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jo diskriminuese. ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t’i ngarkohen</p>	<p>shpërndarjes”, i ndryshuar:</p> <p>Dokumentacioni që kërkohet për lidhje të re ose modifikim lidhjeje ekzistuese në Tension të Ulet për fuqi te instaluar deri ne 20 kW</p> <p>1.Kërkesë për furnizimin me energji elektrike (Formulari i Aplikimit)</p> <p>2.Vertetim i identitetit (fotokopje e Karte identiteti ose pasaportë)</p> <p>3.Fotokopje e Certifikatës e regjistrimit ne QKR (Për subjektet jo familjare)</p> <p>4.Gen-Plani i vendosjes se</p>	
----------	--	---	--	--

			<p>përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë lidhjen në rrjet të një përdoruesi të rrjetit me arsyetimin e kufizimeve të mundshme në të ardhmen të kapaciteteve aktuale të rrjetit apo krijimit të një kufizimi të kapacitetit në pjesë të largëta të sistemit të transmetimit.</p> <p>Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë një pikë lidhjeje të re, bazuar në arsyetimin se do të krijojë kosto shtesë lidhur me nevojën e krijimit të kapaciteteve shtesë të elementeve të sistemit në zonën përreth pikës së lidhjes.</p>	<p>objektit.</p> <p>5.Kopje e kontratës (kartelës) se mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur</p> <p>6.Vertetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si : Akt shitje, akt qiraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundshme.</p> <p>Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar 21-50 kW</p> <p>1.Kërkesë për furnizimin me energji elektrike (Formulari i Aplikimit)</p> <p>2.Vertetim i</p>		
--	--	--	---	---	--	--

			<p>3. ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efçiente për të siguruar lidhjen në mënyrë jo diskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.</p>	<p>identitetit (fotokopje e Karte identiteti ose pasaportë)</p> <p>3.Fotokopje e Certifikatës e regjistrimit ne QKR (Për subjektet jo familjare)</p> <p>4.Gen-Plani i vendosjes se objektit.</p> <p>5.Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur</p> <p>6.Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si: Akt shitje, akt qiraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone te</p>		
--	--	--	---	---	--	--

		<p>4. Rregullorja merr në konsideratë kostot dhe përfitimet që shoqërojnë lidhjen në rrjet të përdoruesve, si dhe rrethanat e veçanta të prodhuesve të ndodhur në zona të largëta dhe zona me dendësi të ulët të popullsisë.</p> <p>5. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin informacion të plotë, përfshirë:</p> <p>a) një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar;</p> <p>b) afatin e nevojshëm e të arsyeshëm për përpunimin e kërkesës dhe të</p>	<p>patundshme.</p> <p>7.Projekti elektrik i objektit, i cili përmban vetëm objektin për të cilin po aplikohet për lidhje te re.</p> <p>8.Plan-vendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.</p> <p>9.Parametrat nominal të të gjitha pajisjeve elektrike të përfshira në projektin elektrik.</p> <p>10.Licencë e inxhinierit elektrik i cili ka bërë projektin elektrik te objektit.</p> <p>11.Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>realizimit të lidhjes me rrjetin.</p> <p>6. Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të licencuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin.</p> <p>Neni 28</p>	<p>projektin dhe përlllogaritja e të dhënave të kryera nga inxhinierë me licencë.</p> <p>Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar mbi 50 kW.</p> <p>1.Kërkesë për furnizimin me energji elektrike (Formulari i Aplikimit)</p> <p>2.Vertetim i identitetit (fotokopje e Karte identiteti ose pasaportë)</p> <p>3.Fotokopje e Certifikatës e regjistrimit në QKR (Për subjektet jo familjare)</p> <p>4.Gen-Plani i vendosjes së objektit.</p>	
--	--	--	---	--	--

			<p>Kostot për lidhjen me rrjetin</p> <p>1. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.</p> <p>2. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj, qëllimi i synuar, modeli i konsumit, kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen, statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes.</p> <p>3. Kur lidhja realizohet prej operatorit të sistemit, kostot e lidhjes parapaguhën nga</p>	<p>5.Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur</p> <p>6.Vertetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si : Akt shitje, akt qiraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone te patundshme.</p> <p>7.Projekti elektrik i objektit, i cili përmban vetëm objektin për të cilin po aplikohet për lidhje te re.</p> <p>8.Plan-vendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.</p>		
--	--	--	---	--	--	--

		<p>pala kërkuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja.</p> <p>4. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga operatorët e rrjetit.</p> <p>5. Në rast të lidhjes së përdoruesve të rinj të rrjetit, pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit</p>	<p>9.Parametrat nominal të të gjitha pajisjeve elektrike të përfshira në projektin elektrik</p> <p>10.Licencë e inxhinierit elektrik i cili ka bërë projektin elektrik te objektit.</p> <p>11.Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritja e të dhënave te kryera nga inxhinierë me licencë</p> <p>12.Leje e ndërtimit e objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike</p> <p>13.Grafiku i</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të aseteve apo në përfundim të autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes, nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre kalon tek operatori i rrjetit. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej përdoruesit.</p> <p>6. Operatori i Sistemit të Transmetimit, bazuar në kushtet teknike të rrjetit, autorizon lidhjen e një përdoruesi të ri në sistemin e transmetimit, nëpërmjet aseteve të</p>	<p>ngarkeses elektrike</p> <p>14.Relacioni analitik për vlerësimin dhe kompensimin e saj</p> <p>SHËNIM PËR APLIKUESIN:</p> <p>Për realizimin e aplikimit mund të përdorni përveç sporteleve të kujdesit ndaj klientit dhe portalin e shërbimit të klientit të OSHEE sha. https://oshee.al/online/</p> <p>Regjistrimi i Lidhjes Së Re dhe Shtesë Fuqie Dhe Transferim Kontrate .</p> <p>Gjatë aplikimit duhet të</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>lidhjes së re të realizuar nga një përdorues i mëparshëm. Përdoruesi i ri përgjigjet për kompesimin e drejtë të kostove ndaj përdoruesit që ka kryer investimin, në përputhje me rregulloren e lidhjeve të reja.</p> <p>7. Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rastin kur vlerëson rëndësinë që kanë asetet e lidhjes, në zhvillimin e sistemit të transmetimit apo shpërndarjes, apo kur këto asete i shërbejnë më shumë se një klienti, ka të drejtën e marrjes në pronësi të një pjese ose të gjithë lidhjes së ndërtuar nga ana e përdoruesit, sipas</p>	<p>respektioni kushtet e caktuara në rregulloren e lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes “VENDIMIT TË ERE’S NR. 166, DATË 10.10.2016 PER MIRATIMIN E “RREGULLOR ES PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”, I NDRYSHUAR</p> <p>Pas aplikimit në portalin e mësipërm duhet të dërgoni brenda 5 ditësh nga data e aplikimit në portal në adresën: Operatori i Shpërndarjes së</p>		
--	--	--	---	---	--	--

			<p>legjislacione civil, kundrajt një kompensimi të plotë të kostove të llogaritura në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e lidhjeve të reja. Neni 29</p> <p>Aksesi i palëve të treta</p> <p>1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jo diskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin</p>	<p>Energjisë Elektrike Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Njësia Administrative Nr. 7, 1023,, Tirana, Shqipëri , dokumentacion in sa vijon:</p> <p>1. Formularin e aplikimit, i firmosur prej personit të autorizuar, i cili gjenerohet pas përfundimit të aplikimit në portal</p> <p>2. Dokumentacion in sa kërkua nga rregullorja e cituar më lart</p> <p>Në rast se dokumentacion original nuk do të depozitohet brenda afatit të</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>në rrjetet elektrike.</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë aksesin në rrjetin e tyre, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.</p> <p>3. Në rast se një pale të interesuar i është refuzuar aksesin në</p>	<p>kërkuar,</p> <p>atëherë kërkesa e juaj do të refuzohet.</p> <p>Kjo procedurë është e vlefshme vetëm për aplikantin që kërkon një fuqi mbi 50kw.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>rrjet, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes pranë ERE-s.</p> <p>4. Në rast refuzimi të aksesit, ERE, nëpërmjet operatorit të rrjetit, i siguron palës së interesuar informacionin shtesë të nevojshëm.</p> <p>Pra sa më sipër, Operatori i sistemit të transmetimit dhe ai i shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jo diskriminuese ku ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			<p>Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të licencuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>nga pala që kërkon të lidhet në rrjet. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj, qëllimi i synuar, modeli i konsumit, kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen, statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes. Kur lidhja realizohet prej operatorit të sistemit, kostot e lidhjes parapaguhën nga pala kërkuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Shpërndarjes, në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga operatorët e rrjetit.</p> <p>Në çdo rast kërkesa për furnizimin me energji elektrike për në objekt (Lidhja me pikën ekzistuese të energjisë elektrike në afërsi të zonës) duhet të përcillet paraprakisht pranë këtyre operatorëve për vlerësimin e kërkesës në përputhje</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			me fushën e përgjegjësisë se tyre			
Të përfitojë asistencë dhe procedurë të përshpejtuar për çdo akt administrativ dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse të kanalizimeve si dhe lidhja me kolektorin e KUZ	PO	Bashkia Himarë	Aktualisht zona ka një prurje dhe një rrjet ekzistues. Pavarësisht kësaj, aktualisht po behet një rikonstruksion i rrjetit te brendshëm të kësaj zone (Perivolo) të ujërave të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza e cila do të krijoje mundësinë e shume pika lidhje dhe përmirësimin e prurjes duke krijuar garanci furnizimi me ujë për këtë subjekt. Në vijim të kësaj parashikohet realizimi i kolektorit kryesor edhe ngritja e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza për të gjithë zonën Gjilekë – Perivol.			
Të përfitojë suport/asistencë dhe procedurë të	PO me kusht, pasi të dorëzojë	MIE ARRSH Bashkia	Nuk ka një kërkesë konkrete për lidhje me infrastrukturë të			

përshpejtuar për çdo akt administrativ për krijimin dhe funksionimin e rrjetit të infrastrukturës lidhëse (rrugët kryesore dhe dytësore për të mundësuar aksesin) për në objekt	studimin subjekti	Himarë	jashtme rrugore. Duhet të përcillet një studim dhe projekti i rrugëve lidhëse (nëse ka) me rrjetin rrugor kombëtar si dhe parashikimet mbi hyrje daljet në rrugët kombëtare. Kjo, me qëllim që sipas parashikimeve ligjore, të përcillet në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për t'u shprehur, në cilësinë e entit kombëtar të rrjetit rrugor.			
---	-------------------	--------	--	--	--	--

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Himarë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimi të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA